



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.27 dt.14.02.1997

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.14.02.1997, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Punëve Publike “Propozim për kalim në fond banese dhe pajisje me autorizim”, në zbatim të Ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, të Vendimit të Këshillit Ministrave Nr.530, dt.17.10.1994, të Dekretit të Presidentit të Republikës Nr.1440, dt.04.04.1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore të pa privatizuara” si dhe të vendimit të K.Ministrave Nr.379, dt.26.06.1995, pika.3.

V E N D O S I;

1. Të kalojë në fond banese objektin (fjetinë – Mencë) e Repartit Ushtarak Nr.5858 që ndodhet në aeroportin Laprakë.
2. Të pajisi me autorizim definitiv për këtë objekt familjen Kaloshi, ish i persekutuar politik me strukturën 3 x (2+1) të ndarë si më poshtë :
 - **Familja Xhevdet Kaloshi (2+1)**
 - **Familja Adriatik Kaloshi (2+1)**
 - **Familja Durime Kaloshi (2+1)**
3. Të miratojë propozimin për privatizimin e këtij objekti si banesë e kategorisë së tretë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Ndërtim Strehimit, pranë Drejtorisë së Përgj.Punëve Publike të Bashkisë.
5. Kryefamiljarët para se të marrin autorizimin të bëjnë deklaratë noteriale se në rast të ndërtimeve sipas studimit urbanistik të zonës heqin dorë nga pronësia mbi këtë banesë për tu sistemuar në banesat e reja
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

